



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 84-të të mbajtur më 31.02.2023 ka miratuar si në vijim.

## VENDIM

Denoncimi me numër 12 - 9548/1 të datës 15.12.2022, me pretendime kundër personit -----, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent për faktin se nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare në detyrë, ndërsa KSHPK nuk ka mundësi të japë informacion shtesë për pretendimet në denoncim për faktin se bëhet fjalë për denoncim anonim.

Lënda me numër 12 - 9548/1 të datës 15.12.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Ky vendim në formë të depersonalizuar do të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur, grup qytetarësh më datë 15.12.2022, është dorëzuar denoncim i regjistruar me numër 12 - 9548/1 të datës 15.12.2022, pas së cilës është formuar lënda me pretendime kundër personit ----- . Raporti i dorëzuar është i shkruar me dorë dhe në të janë bërë pretendime nga kërkuesi i revoltuar ndaj të kallëzuarit, nga të cilat nuk mund të kuptohet se për cilën periudhë dhe për çfarë saktësisht i referohen.

Gjatë shqyrtimit të denoncimit anonim, KSHPK-ja konstaton se në denoncim nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të zyrtarëve në ushtrimin e kompetencave publike dhe detyrave zyrtare, si dhe KSHPK-ja nuk ka mundësi të japë shtesë informacion për pretendimet në denoncim për faktin se është denoncim anonim.

Për këtë arsye, KSHPK-ja vlerësoi se nuk kishte elemente për veprimin e duhur të KSHPK-së për këtë çështje dhe vendosi si në dispozitën e kësaj vendimi.

**KOMISIONI SHETËTORË  
PËR PARANDAËIMIN E KORRUPSIONIT  
Nënkryetare,  
Katica Nikolovska**

Përgatiti: J.C,  
miratoi : Mr. Sh.S, Anëtar i KSHPK-së

